

VENDIM
Nr. 124, datë 4.4.2023

**MBI MIRATIMIN E LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGY 24” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4 pika 1, germa “f”, 5 pika 1, germa “d” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 593/10 prot., datë 31.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Energy 24’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 74, datë 13.3.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy 24” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 14.3.2023 dhe 15.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 593/8 prot., datë 23.3.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i evidentuar dokumentacionin e plotësuar pjesërisht në këtë aplikim. Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 593/9 prot., datë 28.3.2023, duke depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.

- Nga analizimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Energy 24” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c” dhe për pikën 2.4, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy 24” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli